



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MARSELA VESELI
ADRESA RR. ASTRIT SULEJMAN
BALLUKU, APARTAMENTI NR. 2,
HYRJA NR. 5
TEL: 0694013559

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 2154

Nr. koleksioni: 863

Tirane më 02/06/2022


Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

*Akti noterial përbëhet nga 4 fletë



A2022053740101288304



KONTRATË SHITJE KUOTA KAPITALI ME REZERVE

(TË SHOQËRISË "ALB SHPRESA" SH.P.K)

Sot, më datë 02/06/2022, para meje Notere MARSELA VESELI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, RR. ASTRIT SULEJMAN BALLUKU, APARTAMENTI NR. 2, HYRJA NR. 5, u paraqit personalisht:

SHITES: Mehdi Lala, atësia Lutfi, amësia Hafe, shtetas Shqiptar, lindur në Buzmadh, Kukës dhe banues në TIRANË, me adresë Sejdini; Nd. 27; H. 1; Njësia Administrative Nr. 9; Njësia Bashkiake Nr. 9; 1017; Tiranë, lindur më 12/03/1961, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033486759 dhe nr. personal G10312069G.

Zj. Agime Lala, e bija e Emin lindur me 19/06/1971, ne Kukes dhe banuese në Rr Jordan Misja , Tirane , madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me numer 035625211 dhe numër personal H15619175I, në cilësinë e bashkëshortes se Z. Mehdi Lala

BLERES: Hauard Malo, atësia Muamet, amësia Miranda, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë Akacia 03910007; Nd. 44; H. 1; Farkë; Mjull Bathore; 1045; Tiranë, lindur më 23/12/1995, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporte Biometrike nr. BB9441725 dhe nr. personal J51223047O, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "ALB SHPRESA" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

BAZA LIGJORE

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";
- 3.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Kushtet Paraprake

- Shoqëria "ALB SHPRESA" sh.p.k, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më date 28.08.1997, e pajisur me Certifikatë Regjistrimi NUIS (NIPT)



A2022053740101288304

J72110003F; me zyrë qendrore në Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 9, rruga "Sejdini", Ndertesa Nr.25, Kodi Baneses 290; me kapital të regjistruar 88.750.000 lekë me ortak te vetem Z.Mehdi Lala, zotërues i 88.750,00 kuotash.

- Pala shitëse është e interesuar të shesë te gjitha kuotat e saj te cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "ALB SHPRESA" SHPK dhe pala blerëse është e interesuar të blejë këto kuota;
- Palët kanë rënë dakord që çmimi i kësaj kontrate do të paguhet nga pala blerëse sipas kushteve dhe afateve te kontrates;

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

II. OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse z.Mehdi Lala, i shet palës blerëse Z. Hauard Malo te gjitha kuotat që ai zotëron në shoqërinë "Alb Shpresa" shpk te cilat përbëjnë 100% të kapitalit të kësaj shoqërie.

2.2 Pas regjistrimit të kësaj kontrate ne QKB, ortak i vetem i shoqërisë "Alb Shpresa" SHPK, do të jetë:

- Z. Hauard Malo i cili do të jetë zotërues i kuotave qe perfaqesojne 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Alb Shpresa" shpk;

III. ÇMIMI

3.1 Palët kane rene dakord që çmimi i shitjes së kuotave që përfaqësojnë 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Alb Shpresa" SHPK do te jete 90'000 (nentedhjetemije) Euro ne total.

3.2 Palët kane rene dakord që çmimi i shitjes prej 90'000 (nentedhjetemije) Euro, do te paguhet me keste si vijon:

- Kesti i pare ne vleren 50'000 (pesedhjetemije) Euro do të paguhet nga pala blerëse brenda 2 diteve kalendarike pas nënshkrimit te kontratës në llogarinë bankare të Noterit .

Pas rregjistrimit te kesaj kontrate ne QKB dhe kalimit te kuotave te kapitalit ne emer te blesit Noteri do te kaloje shumen prej 50'000 (pesedhjetemije) Euro ne llogarine bankare te shitesit Mehdi Lala.

- Kesti i dyte ne vleren 40'000 (dyzetemije) Euro do të paguhet nga pala blerëse brenda dates 30 Korrik 2022 në llogarinë bankare të Noterit per tu transferuar me pas ne llogarine e pales shitese Mehdi Lala.

IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

4.1 Pala blerëse dhe/ose personat e caktuar prej saj kanë të drejtë të ketë akses në të gjithë dokumentacionin juridik, financiar dhe teknik të shoqërisë "Alb Shpresa" SHPK.

4.2 Pala blerëse detyrohet të paguajë çmimin e kontratës brenda afateve te percaktuara ne nenin 3.

4.3 Palët e kësaj kontrate detyrohen që asnjëra prej tyre të mos tërhiqet nga kjo kontratë.



A2022053740101288304

4.4. Shitesi deklaron dhe garanton bleresin se 100 % i kapitalit qe po trasferohet me ane te kesaj kontrate eshte ne pronesi te tij te plote ligjore dhe e lire nga cdo barre,hipoteke, pengje apo pretendim i te treteve.

4.5 Me blerjen e kuotave te kapitalit te shoqerise sipas kesaj kontrate bleresi bie dakort me te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe lindin nga zoterimi i ketyre kuotave, sipas statutit te shoqerise dhe ligjit me perjashtim te detyrimeve te pasqyruara ne deklaraten noteriale Nr.2136 Rep. Nr. 862 Kol., date 02/06/2022 te nenshkruar nga shitesi per kete qellim, te cilat do te mbulohen prej ketij te fundit.

4.6 Te drejtat dhe detyrimet e shoqerise jane te pasqyruara dhe ne bilancin e shoqerise te dates 31/03/2022.

V. KALIMI I PRONËSISË

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shitblerje kuotash kapitali, pavaresisht se eshte nje kontrate shitblerje me rezerve, do të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) menjëherë pas nënshkrimit të saj dhe Z. Hauard Malo do të bëhet ortak i vetem i shoqërisë "Alb Shpresa" SHPK, duke zotëruar 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

5.2 Me nënshkrimin e kesaj kontrate dhe regjistrimit e saj ne QKB si me siper pershkruhet, pronësia mbi te gjitha kuotat qe perbejne 100% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "Alb Shpresa" SHPK, do të kalojë nga pala shitëse Mehdi Lala tek pala blerëse Z. Hauard Malo dhe pala shitëse humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotat qe përfaqësojne 100% të kapitalit në shoqërinë "Alb Shpresa" SHPK dhe këto të drejta fitohen nga pala blerëse.

VI ANEKSET E KONTRATËS

Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneke të Kontratës;

- Vendimi i Ortakut te vetem me nr. 7 datë 02/06/2022 bashkëlidhur
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese,
- Certifikatë familjare e palës Shitëse;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

VII DHËNËSI I PËLQIMIT

Dhënësi i pëlqimit bashkëshorte e ortakut Mehdi Lala dhe bashkëpronare në kuotën që z.Mehdi Lala zotëron në shoqërinë "Alb Shpresa" SHPK. për efekt të martesës, deklaron se është dakord që kuotat, objekt i kësaj kësaj kontrate, në pronësi të bashkëshortit të saj, t'i shiten Z. Hauard Malo sipas kushteve te kesaj kontrate.



A2022053740101288304

Dhënësja e pëlqimit deklaron se nuk ka asnjë pretendim lidhur me këtë vendimmarrje të bashkëshortit të saj për shitjen e kuotave dhe nuk do ketë asnjë pretendim në të ardhmen lidhur me këtë shitje dhe kalimin e shumes totale të shitjes sipas kësaj kontrate në llogarinë e bashkëshortit të saj.

Kjo kontratë hartohet në 5 (pesë) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një qëndron në arkivën noteriale, një origjinal regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë.

Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

13.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

13.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA SHITËSE

Mehdi Lala

DHËNËSI I PËLQIMIT

Agime Lala

PALA BLERËSE

Hauard Malo

Notere
MARSELA VESELI

TE DHENAT E LLOGARISE SE TJETERSIMIT TE NOTERIT "ESCROW" SIPAS
UDHEZIMIT Nr. 20, date 14/09/2020 "Per proceduren teknike per kryerjen e
pageses ne rastet e kalimit te pasurive te paluajtshme"

EMERTIMI I LLOGARISE

MARSELA VESELI P.F TJETERSIM PASURIE

EMRI I BANKES

CREDINS BANK SHA.

IBAN : AL60 2121 1171 0000 0000 0092 6832 LLOGARIA E EUR

Noteri

[Signature]

[Signature]

